



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 18.12.2025
Kodi i ZRRE-së: V_3009_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2757_09_25** i datës 29.09.2025;
- Ankesa e konsumatorit e dt. 23.10.2025.

në seancën e mbajtur më datë 18.12.2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **A. Sh.**, nga Komuna e Pejës, si e pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK_V_2757_09_25 i datës 29.09.2025.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 29.09.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2757_09_25 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit A. Sh., për mos matje të saktë të njehsorit elektrik me nr. 87441054.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Njehsori elektrik i cili vetëm për 6 ditë, pa u venë në funksion fare, ka regjistruar shumë prej 137 €, në një lokal prej 10m2 dhe pas intervenimit tim, ora është ndërruar dhe tani e paguaj me rregull tarifën fikse të orës, sepse nuk ka shpenzim tjetër, se lokali nuk është në funksion;
- Jam ngarkuar padrejtësisht me një faturë për energjinë elektrike të cilën nuk e kam shpenzuar;
- Kërkon rishqyrtimin e ankesës së tij dhe të korrigjohet nga fatura e kontestuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 18.12.2025 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Transaksionet e konsumatorit, Rrjedha e Energjisë Elektrike, Listat e Leximit, Procesverbalin e ndërrimit të njehsorit me nr. 0871248 i dt. 05.01.2025, Procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit me nr. 1780 e dt. 24.03.2025, Procesverbalin për pranim të instalimit elektrik si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Bordi i ka analizuar me kujdes Transaksionet e konsumatorit dhe ka gjetur se shifra DPE – 9076748 i është hapur konsumatorit me dt. 20.12.2023, dhe se nga kjo kohë, konsumatori ishte lexuar dhe faturuar me rregull, dhe nuk ishte evidentuar asnjë parregullsi në këtë pikë matëse të konsumatorit. Po ashtu, edhe në Lista të Leximit nuk është evidentuar asnjë parregullsi në pikën matëse të konsumatorit.

Duke iu referuar dokumentacionit relevant, Bordi ka gjetur se, konsumatorit i është ndërruar njehsori me dt. 05.01.2025, sipas Procesverbalit me nr. 0871248 mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik, ashtu që, nga matja ishte larguar njehsori me nr. 87441054 me gjendje të shpenzimeve prej TL – 750 kWh dhe TU = 562 kWh, dhe për matje ishte vendosur një njehsor i ri me nr. 87440981, me gjendje të shpenzimeve në TL dhe TU = 0000 kWh. Dhe në vërejtje të këtij procesi ishte evidentuar si në vijim: *“I bëhet ndërrimi i njehsorit elektrik. Njehsori i vendosur me dt. 19.12.2023 – lokali ende i mbyllur, i paaktivizuar dhe ankesa e konsumatorit për shkak të kWh në njehsor. Njehsori elektrik dërgohet për shqyrtim në kalibrim”*. Më tej, Bordi e ka analizuar edhe gjendjen e shpenzimeve të konsumatorit të evidentuar në këtë procesverbal dhe kjo gjendje përputhet me gjendjen e konsumatorit të evidentuar në Rrjedhën e Energjisë Elektrike ose në CCP të konsumatorit.

Bordi po ashtu e ka analizuar edhe Protokollin e Testimit të Njehsorit Elektrike – Elektronik në Qendrën Laboratorike nga KEDS dhe me nr. 1780, të dt. 24.03.2025, dhe gjatë testimit të njehsorit elektrik është konstatuar si në vijim: *“Njehsori elektrik është në rregull, njehsori elektrik mund të lexohet në mënyrë softuerike, njehsori elektrik i ka pllombat shtetërore dhe njehsori elektrik mund të testohet”*. Ndërkaq, nga rezultatet e testimit të njehsorit në tarifë është konstatuar se – gabimi në përqindje është +0.53. Në këtë kuptim, rezulton se, njehsori elektrik me nr. 87441054 është brenda kufijve të lejuar të matjes, duke iu referuar dispozitave ligjore të përcaktuara në Kodin e Matjes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Përfundimisht, Bordi ka gjetur se, pretendimet e konsumatorit për mos matje të saktë të njehsorit elektrik nuk qëndrojnë, sepse, nga sa u pa më sipër, pas kontrollimit detal të njehsorit nga Qendra e Kalibrimit, i njëjti ka rezultuar se është brenda kufijve të lejuar të matjes dhe se nuk ishte evidentuar asnjë parregullsi tjetër ose defekt në këtë njehsor.

Bordi thekson se, Furnizuesi KESCO ka vepruar në harmoni me legjislacionin në fuqi, ashtu që, konsumatori është lexuar dhe është faturuar me rregull dhe nuk është evidentuar asnjë parregullsi në këtë pikë matëse, sipas nenit 28 – Faturimi, të Rregullës për Kushtet e përgjithshme të Furnizimit me Energji, si në vijim: *“Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori*



dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit”.

Duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, *“të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”,* andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i pati në konsideratë edhe disa prova të tjera materiale si në shkresat e lëndës, por që të njëjtat nuk kanë pasur ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me këtë rast.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO;
- Konsumatorit **A. Sh.**,
- Arkivit të ZRRE-së